



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:045922

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06358940

**C.nr.590/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Asdren Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. Sh., me vendbanim në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokateve: Studio Ligjore & Financiare “K. A. me avokatet e saj, me adresë Blv. “D. e K.”, U. C-..., kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me adresë në rr. “N. G.”, P., e përfaqësuar nga përfaqësuesi i komunës për konteste juridike F. R., me objekt kontesti: kompensimi për ushqim gjatë punës, me vlerë kontesti: 330.00 €, jashtë seance, me datë 26.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit N. Sh.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N. Sh, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit (shujtave) për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2022, deri me datën 21.11.2022, respektivisht për 165 ditë pune, të ia kompensojë shumën prej 330.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 22.02.2023 (data e parashtrimit të padisë), deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- III. DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N. Sh, të ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 99.00 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi N. Sh me datën 22.02.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e ka plotësuar me datën 18.10.2024, ku ka kërkuar

kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës, në shumën prej 330.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

I njëjti në padi ka theksuar se është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura në vendin e punës, mësimdhënës në SH.F.M.U “Sh. M.” në P.. Ndër të tjera ka theksuar se e paditura përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave, të cilat rrjedhin nga Kontrata e Kolektive e Arsimit, e nënshkruar me 18.04.2017, dhe kontratës individuale, nuk ka bërë kompensimin e shujtave (ushqimit) për ditët e pranisë në puna nga 2 euro, prej datës 01.03.2021, deri më ditët e parashtrimit të kësaj padie konform dispozitave të nenit 35 par. 5 dhe 7 te marrëveshjes se cekur dhe Ligjit te Punës. Ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave dhe mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor ta aprovoi ne tërësi si te bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Tutje ne plotësim te kërkesëpadisë të datës 18.10.2024 shton se paditësi kompensimin e kërkon nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022 për 165 ditë nga 2 euro ne shumë totale prej 330.00 €. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 24.10.2024, ka theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit për kompensim të shujtave, të paraparë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit Para Universitar, të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021. Tutje shton se në nenin 46 të Kontratës Kolektive është paraparë që MASHT-i dhe SBASHK-u të angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35 dhe paragrafët 5,7 dhe 8 të kësaj kontrate, andaj nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve të punëtorëve të arsimit. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin të shujtave ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si dhe fakti se e paditura nuk e ka bërë kompensimin e shujtave për periudhën e cekur në padi dhe në plotësim të saj.

Andaj, gjykata, komform nenit 398 të LPK-së, gjeti së kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo duke pasur parasysh se nuk ishte kontestuese lartësia e kërkesëpadisë, si dhe duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje: KKAK) të dt.18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, konkretisht nenit 35 par.7, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë është, për një ditë punë, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionin arsimor”*.

Me dispozitën e nenit 2 të KKAK-së, parashihet se dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucione të arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD të universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të fakteve të cilat i kemi cekur më lartë, si dhe dispozitave të lartcekura, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit të ia kompensojë shujtat për ditët e pranisë në punë, ashtu që, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e KKAK-së, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga prova që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe e njëjta nuk ishte kontestuese.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës, dhënë në përgjigjen në padi lidhur me atë se kontrata kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me këtë kontratë, dhe se nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara, ngase e paditura lidhur me pagesën e kompensimit të shujtave obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga KKAK, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prandaj është edhe i relevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive.

Lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, duke e llogaritur nga data 22.02.2023, dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve, gjykata e vendosi në bazë të nenit 382 par. 2 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Mendimit Juridik për Kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 par.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, ndërsa lartësinë e tyre e mbështeti në Rregulloren e Tarifës së Avokatëve të Kosovës e vitit 2017, ndërsa për taksë gjyqësore iu referua Udhëzimit Administrativ për Taksa Gjyqësore nr. 01/2017, ku në rastin konkret, e paditura është obliguar që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 99.00 euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 78.00 euro, kurse në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21.00 euro. Gjykata e refuzoi kërkesën e paditëses për kompensimin e parashtresës për plotësim të padisë, pasi që vlerësoi se është shpenzim i bërë pa fajin e të paditurës, duke pasur parasysh se paditësja të njëjtin plotësim është dashur ta paraqes me anë të padisë dhe për këtë arsye i është kthyer në

plotësim padia. Po ashtu, gjykata vlerëson se paraqitja e padive të mangëta, plotësimi i të njëjtave pas kërkesës së gjykatës dhe kërkimi i shpenzimeve për këto plotësime është keqpërdorim i të drejtave në procedurë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.590/23, datë 26.10.2024**

**Gjyqtari**  
Asdren Hasani

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.